



Komuna e Klinës

Zyra e Kryetarit

01Nr-06-28368/2019

Klinë, 21. 06. 2019

06.07.2019

PROCESVERBAL

Nga takimi i I-rë me Qytetarë për vitin 2019, i Kryetarit të Komunës, z. Zenun Elezaj, mbajtur më 21. 06. 2019, filluar në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, në hapje të këtij takimi, ju uroi mirë se ardhje gjithë të pranishmëve duke theksuar se ky është debati me qytetarë për periudhën e parë të vitit.

“ Mirë se keni ardhur në këtë takim-debat, ku do të diskutojmë lidhur me mbarrëvajtjen e proceseve të investimeve kapitale dhe gjitha proceseve të tjera në Komunën e Klinës, për periudhën e parë të vitit 2019 ”, theksoi kryetari i Komunës, z. Elezaj. Duke folur për projektet e realizuara në 6-të mujorin e parë të këtij viti, problemet, vështirësitë dhe sukseset që e kanë karakterizuar këtë periudhë kohore, kryetari, Zenun Elezaj, tha:

Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Do të mundohem që në pika të shkurtra të përfshij aktivitetet tona në këtë 6-të mujor. Ju e dini që viti kalendarik shoqërohet me një buxhet të aprovuar nga viti paraprak. Në shtator të vitit 2018 është aprovuar buxheti për vitin 2019 dhe në fillim të vitit 2019 fillojnë përgatitjet e nevojshme për implementimin e të gjitha mjeteve financiare të dedikuara për këtë vit. Më duhet të ju them se ky vit ka qenë i shoqëruar me disa vonesa pasi që buxheti për vitin 2019 është aprovuar me vonesë edhe në parlamentin e Kosovës. Por, pavarësisht prej kësaj, ne ja kemi arritur që të bëjmë përgatitjet e duhura dhe të jemi konform planifikimit të bërë. Dua të theksoi se që nga shkurti i vitit 2019 kanë filluar procedurat përgatitore për shpalljen e tenderëve, e që duke kërkuar durimin tuaj, më lejoni që ti listoi projektet që janë tenderuar, janë në implementim apo janë kryer me sukses:

1. Projekti i furnizimit me zhavorr për mirëmbajtjen e rrugëve lokale, një projekt me rreth 42.000 euro, kontrata e këtij projekti është në zbatim e sipër, pothuajse në përfundim.
2. Ndërtimi i kanalizimit në Kpuz- është një projekt prej 86.000 euro dhe që është në realizim e sipër. Në fazën e përfundimit gjithashtu.
3. Ndërtimi i kanalizimit në Resnik- Projekt prej 63.700 euro, në fazën përfundimtare të realizimit.
4. Ndërtimi i kanalizimit në Sferkë. Projekt ky në vlerë prej 34.000 euro, që është duke u realizuar.
5. Ndërtimi i kanalizimit në Qupevë të Ulët, në vlerë 19.400 euro. Në përfundim e sipër.
6. Rregullimi i varrezave të qytetit, projekt në vlerë prej 59.500 euro dhe që është në realizim.
7. Asfaltimi i rrugës në Budisalc, në vlerë prej 38. 000 euro, projekt që është duke u realizuar.
8. Asfaltimi i rrugëve në Stupë, projekt që është duke u realizuar dhe që ka koston 43.000 euro.
9. Asfaltimi i rrugëve në fshatin Siqevë- projekt me vlerë prej 71. 371 euro. Edhe ky projekt është duke u realizuar.
10. Asfaltimi i rrugëve në Gjurgjevik të vogël, në vlerë prej 117.000 euro, është në realizim e sipër.

11. Asfaltimi i rrugëve në Çeskovë, projekt në vlerë 107.000 euro dhe që është duke u realizuar.
12. Rregullimi i oborrit tek Kulla në Çabiq, projekt në vlerë prej 44.000 euro që është në fazën finale të përfundimit.
13. Ndërtimi i kanalizimit në Radulloc, ku vlera e këtij projekti pothuajse në përfundim është 54.000 euro.
14. Ndërtimi i kanalizimit në Jashanicë. Projekt në realizim e që ka vlerën 44.000 euro.
15. Ndërtimi i kanalizimit në Deiq, projekt në vlerë prej 64.900 euro. Në realizim.
16. Ndërtimi i kanalizimit në Dollovë. Vlera e projektit 45.700 euro. Në fazën e fillimit të realizimit.
17. Hartimi i elaboratit për ujë të pijshëm. Vlera e projektit 11.600 euro. Është caktuar kompania dhe është duke kryer hulumtimet e nevojshme për furnizim me ujë të pijshëm në fshatin Budisalc dhe për fshatin Gllarevë, ku zonë e interesit për hulumtim për ujë të pijshëm është fshati Përqevë dhe liqeni ku është e vendosur kompania "Hidrodrini"

Për të gjitha këto kanë përfunduar procedurat e prokurimit, janë shpallur kompanitë fituese dhe projektet janë në implementim e sipër. Ndërsa rrugët e tjera të planifikuara janë në fazën e kontraktimit, siç janë:

1. Asfaltimi i rrugës Përqevë – Sferkë. Vlera e projektit: 145.000 euro. Faza e nënshkrimit të kontratës.
2. Renovimi i shkollës në Kërrnicë. Vlera e projektit: 17.400 euro.
3. Meremetimi i objektit të shkollës në Jagodë. Vlera e projektit: 9.800 euro, pjesa e dytë kjo pasi që është meremetuar vitin e kaluar.
4. Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Ranoc. Vlera e projektit: 43.900 euro.
5. Ndërtimi i kanalizimit në Dresnik. Vlera e projektit: 22.900 euro.
6. Ndërtimi i kanalizimit në Dolle. Vlera e projektit: 12.200 euro.
7. Ndërtimi i kanalizimit në lagjet e qytetit. Vlera e projektit: 52.500 euro.
8. Renovimi i objektit të QKMF "Nënë Tereza". Do të ketë ndërhyrje në komplet objektin e QKMFS-së. Përveç "Shërbimit Emergjent", pasi që ky shërbim është rinovuar vitin e kaluar. Do të kemi kushte me të mira dhe shërbime më të mira për qytetarët, pas realizimit të këtij projekti vlera e të cilit është 22.200 euro. Edhe ky projekt sikurse të tjerët është në fazën e kontraktimit.

Ndërkaq projektet që janë në fazën e tenderimit ose vlerësimit d.m.th. projektet për të cilat janë shpallur tenderët, janë:

1. Asfaltimi i rrugës Stupë-Zajm.
2. Hartimi i projekteve për rrugë. Këtu kemi një problem pasi që ende nuk kemi një kompani projektuese shkak i ankesave që po bëhen. Në mungesë të kompanisë, jemi të detyruar që të angazhojmë stafin e Komunës që vet ti punojnë projektet. Kështu në këtë mënyrë, arsyeja e angazhimit të madh shtesë të këtij stafi po ndodhë të kemi vonesa në shpallje. Megjithëkëtë, mendoj që këtë vit jemi në një fazë më të hershme dhe më të mirë se sa vitin e kaluar dhe jemi në përfundim të të gjitha proceseve.
3. Furnizimi me sera. Subvencionimi që do të ju bëhet fermerëve.
4. Asfaltimi i rrugës në Sferkë, Volljakë, Qupevë, Dugujevë, Grabanicë.
5. Meremetimi i Urës nën të cilën kalon lumi "Lumbardhë" i Pejës.

6. Asfaltimi i rrugëve në Dollovë, Grabanicë, Dush, Jelloc- Është një grand që e kemi fituar nga ministria e zhvillimit rajonal, rreth 130.000 euro dhe që Komuna do të bashkëfinancim në shumën rreth 230.000 euro.
7. Asfaltimi i rrugës Kpuz-Mrasor, projekt që mbështetet nga ministria e infrastrukturës në vlerë rreth 300.000 euro.
8. Asfaltimi i rrugëve në qytet.
9. Asfaltimi i rrugëve në Caravik.
10. Ndërtimi i trotuarit në Zabergjë dhe rehabilitimi i kroit në Çabiq.
11. Asfaltimi i rrugëve në Jashanicë.
12. Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës përcjellëse në fshatin Poterq, faza e dytë.
13. Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Kpuz, faza e dytë.
14. Asfaltimi i rrugës Açarevë-Siqevë, grand nga Ministria e Infrastrukturës.
15. Asfaltimi i rrugës së infrastrukturës nëntokësore-Galerisë në qytet
16. Asfaltimi i rrugës në Shtupel.
17. Mirëmbajtja dhe riparimi i ndriçimit publik.
18. Ndërtimi i tribunave lindore në stadiumin e qytetit.
19. Ndërtimi i fushës së sportit në shkollën e Zajmit.
20. Asfaltimi i rrugës Pataqan-Raduloc.
21. Asfaltimi i rrugëve në Dollc, edhe kjo sikurse projektet që i përmenda së fundmi, është në fazën e tenderimit.

Pra, këto janë projektet, që janë realizuar, disa janë në realizim e sipër dhe të tjerat në fazën e vlerësimit dhe tenderimit, të parapara në buxhetin e vitit 2019. Kanë mbetur edhe disa projekte që lidhen me kanalizime e që arsyeja është problemet me kompaninë projektuese. Bëhet fjalë për kanalizimin në Bokshiq, në Berkovë, Jagodë që janë ende në fazën e përgatitjes së dosjeve dhe materialit për tenderim. Mendoj që para datës 15 korrik, të gjitha projektet kapitale të parapara për vitin 2019 do të i nënshtrohen procedurave të tenderimit.

Disa rrugë nuk kanë arritur me u përfunduar në vitin 2018 dhe kanë kaluar në realizim për vitin 2019 shkaku i problemeve që kompanitë kanë pasur me mungesë të bitumonit. I kuptoi plotësisht shqetësimet e qytetarëve në lidhje me këtë, por gjithsesi, ne, do të përkujdesemi që ato shqetësime të zgjidhen në mënyrën më të mirë. Në fund dua të ju siguroi se për të gjitha projektet e realizuara dhe të pranuara, ka garanci një vjeçar. Gjatë kësaj periudhe të afatit të garancionit, çdo mangësi apo dëmtim, kompania do të përgjigjet dhe do ta rregulloi me koston e vet. Përrjashtoj këtu projektin e rrugës me kubza në qytet, i cili projekt po zgjatë që disa vite. Tani së fundmi është duke u bërë lidhja e ujësjes në galeri prandaj ndodhë që të ketë edhe ndërprerje të shkurtra të furnizimit me ujë por që jemi kujdesur që të i njoftojmë me kohë qytetarët. Ka investime të mëdha dhe të shumta në zëvendësim, riparim dhe mirëmbajtje të rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë, projekte që po financohen nga Komuna, kompania "Hidrodrini" por edhe nga CDI, organizatë e popullit Zvicëran.

Ka projekte që vazhdojnë që nga viti 2015, 2016. Projekti në Gjurgjevik të Madh që nga 2016 nuk ka pasur buxhet. Këtë vit e kemi siguruar buxhetin. Është projekti i Qendrës Rinore që ende nuk ka përfunduar dhe që ka probleme pronësore, ku Komuna është në Gjykatë pasi që është ndërtuar objektin në pronë private, atëherë kur është ndërtuar. Janë edhe disa rrugë që vazhdojnë nga viti 2016 siç është rruga Jashanicë-Ujmirë, rruga Krushevë e Madhe. Këtë vit kam bërë edhe ndryshime në menaxhimin e projekteve. Për dallim nga viti i kaluar ku projektet i kanë menaxhuar drejtorët, këtë vit kontratat i

menaxhojnë inxhinierët që i kemi angazhuar dhe përgjegjësia bije direkt mbi menaxherët e kontratave. Me këtë ndryshim të bërë, jam shumë më i kënaqur pasi që edhe projektet janë shumë më të suksesshme.

I përmenda në pika të shkurtra të gjitha këto projekte, pa u ndalur në detaje dhe specifikat e tyre. Ju falënderoi për durimin tuaj. Jam i gatshëm që të bashkëbisedoj me ju.

z. Bajram Elezi: Faleminderit kryetar. Unë dëshiroi që të informohem në lidhje me furnizimin me ujë në fshatin tonë, në Gjurgjevik të Vogël.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Në shumicën e fshatrave të Komunës, siç e dini, furnizimi me ujë të pijshëm është i vështirësuar. Jemi duke bërë përpjekje së bashku me "Hidrodrini", përfshi këtu edhe një studim që jemi duke e bërë, për rritjen e kapaciteteve të fabrikës. Fabrika në fjalë ka qenë e projektuar që të prodhoi 90 L/s, por që tani jep vetëm 20 L/s, për shkak të mbylljes së filtrave dhe ndoshta për shkak edhe të mos implementimit të një pjese të projektit –para filtrimi. Jemi duke u orientuar që furnizimin me ujë ta bëjmë nga objekti i fabrikës duke e rritur kapacitetin në 100 L/s, duke i ndërruar filtrat dhe kur të përfundoi projekti deri me 15 korrik që e kam theksuar më herët, ne do të drejtohem i Qeverisë për financim sepse nuk kemi buxhet si Komune. Gjurgjeviku i V. e ka një problem sepse furnizohet me ujë nga Jashanica e Epërme. Derisa të vije uji në Gjurgjevik nga atje, harxhohet, pasi që nga të njëjtit gypa furnizohen edhe fshatrat para Gjurgjevikut, siç janë, Kërrnica, Shtupeli, Jashanica. Me projektin e ri që e ka bërë CDI, është menduar që Gjurgjeviku të lidhet direkt me burimin e ujit në Jerinë. Ky projekt do të implementohet këtë vit, në fakt jemi duke pritur që dita-ditës të filloi së implementuari. Janë edhe disa çështje duke u përfunduar në lidhje me këtë burim, analizat e ujit nga ky burim janë duke u bërë nga GIZ Gjerman. Nëse këto analiza dalin që uji nga ky burim nuk mund të shfrytëzohet për pije, atëherë do të orientohem në fabrikën e përpunimit të ujit që e kemi.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje për gjithë të pranishmit. Unë fillimisht dua të të falënderoi për përfshirjen e të gjitha vendbanimeve të Komunës në projekte të ndryshme. Dëshiroi që të shpreh një shqetësim të banorëve të fshatit Deiq. Jemi 20 shtëpi që me vet kontribut kemi bërë lidhjen në sistemin e furnizimit me ujë porse ka 3 vjet që na është hequr pompa e furnizimit. Edhe para 3 viteve ia kam thënë drejtorit të "Hidrodrini" në këtë sallë se unë e kuptoi që kur të priset pompa e furnizimit, mbesim pa furnizim me ujë por nuk e kuptoi seleksionimin e bërë për furnizim. Thënë ndryshe: Ke pi ti ujë mjaft, tani po ja jap që të pijë dikush tjetër. Prej atëherë, d.m.th., 3 vjet, nuk është kthyer në funksion ajo pompë e furnizimit. Kërkoj nga ju kryetar që të angazhoheni rreth kësaj dhe të paket ato investime që i kemi bërë ne banorët e Deiqit, të jenë funksionale.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Faleminderit. Studimi që po bëhet do të ketë parasysh edhe këto komponentë dhe do të ecë në faza. Për momentin ekziston ideja se 100 L/s mund ti sigurojmë deri vitin e ardhshëm. Me sigurimin e këtyre 100 L/s, do të rikthehet furnizimi me ujë edhe për fshatrat Zajm dhe Deiq.

z. Bardhec Mrijaj: I nderuar kryetar. Unë e kam braktisë Zllakuqanin shkaku i rrugës. Kam blerë vend dhe ndërtuar shtëpi në Videjë. Aty ku jam vendosur unë, jemi 7 shtëpi. Rruga ku gravojmë ne 7 shtëpitë është në gjendje të tmerrshme dhe nuk mund të kalohet as me traktor. Kam qenë disa herë tek ju me kërkesën që të na shtrohet të paktën me zhavorr ajo rrugë. Ju kisha lutur që të na ndihmoni me shtrimin e kësaj rruge me zhavorr meqenëse me asfalt nuk ka mjete.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: E thash edhe më herët se projekti i parë që kemi filluar këtë vit ka qenë furnizimi me zhavorr për rrugët e fshatrave të Komunës. Por, për shkak të nevojave të mëdha dhe për shkak të gjendjes klimatike që e kishim, rrugët e fshatrave Radulloc, Pataqan, Zllakuqan, Ranoc etj. janë dëmtuar më shumë dhe na është dashtë që të intervenojmë kryesisht atje. Mendoj që është në fazën e mbylljes ky projekt. E kemi edhe një projekt që do të realizohet, është ai i shtrimit të rrugëve në Gjurgjevik të Madh me zhavorr, e në këtë projekt do ta mendojmë një komponentë shtesë shkaku i nevojave të mëdha. Prandaj do të bëjmë të pamundurën që të furnizojmë dhe shtrojmë me zhavorr rrugët e nevojshme.

z. Refki Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë. Kam dy shqetësime që lidhen me aspektin jo personal. A ka komuna ndonjë projekt që të zgjeroi rrugën deri tek udhëkryqi Pejë-Prishtinë? Dhe shqetësimi i dytë është ndotja e ambientit, në veçanti nga ura e gurit deri tek fabrika e ujit, përgjatë bregut të lumit "Klina", ku përmes disa gypave derdhen ujërat e zeza në lum. Çfarë ka në plan komuna, që ta ndërpres ndotjen e Madhe të Lumit "Klina"?

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Rrugën në hyrje të qytetit nuk kemi planifikuar që ta ndërtojmë pasi që gjithçka ndërlidhet me projektin e autostradës Prishtinë-Pejë, ku tek ETC është kyçja për qytetin e Klinës dhe kjo pjesë e rrugës për të cilën fole ti do të jetë pjesë e autostradës. Disa herë i kam informuar qytetarët që projekti për rrugën transit është gati. Ky projekt do të filloi këtë vit. Ky transit do ta shkarkoi shumë ngarkesën e qytetit me makina pasi që të gjithë udhëtarët me makina që duan të shkojnë në Skënderaj ose në Istog-Burim, do të kalojnë nëpër transit dhe jo nëpër qytet. Pra, arsyeja pse nuk kemi marr ndonjë hap për ndërtimin e kësaj rruge është lidhja me autostradë. Sa i përket mbrojtjes së mjedisit, ju keni të drejt, por ne jemi duke u angazhuar që përmes fondeve nga BERZH, jemi duke biseduar edhe për një fond të quajtur "Kredi të Buta" Austriak, fondin Hungarez dhe Slloven. Pra jemi duke bërë përpjekje në tre drejtime por në rast të dështimit nga këto fonde, e kemi planin rezervë, ku në buxhetin e vitit 2020 e kemi futur studimin e fizibilitetit për trajtimin e ujërave të zeza dhe mendoj që i vetmi projekt që e zgjidhë këtë shqetësim që e përmende është ai. Me gjithë këtë, këtë vit do ta kemi një impiant të vogël në Volljak. Volljakun e ka zgjedhë CDI. Fokusi ynë këtë vit është që të minimizojmë ndotjet e lumit "Drini i Bardhë" nga ura e hekurit në drejtim të Zllakuqanit dhe Rudices. Ndërsa për vitin 2021 kemi futur në buxhet edhe projektin e ndërtimeve të dy impianteve për trajtimin e ujërave të zeza në fshatrat afër lumit "Drini i Bardhë" krejt kjo me qellim që të evitojmë ndotjen e këtij lumi pasi që nga ky lum furnizohet fabrika për përpunimin e ujit.

z. Xhevxhet Berisha: Përshëndetje kryetar, përshëndetje për gjithë të pranishmit. Do të doja që ta pyes kryetarin se a është në planifikim ndërtimi i një trotuari në rrugën e Sferkes pasi që kjo rrugë është e rrezikshme për fëmijët që e kalojnë atë. Është rrugë e ngjeshur me automjete nga tre fshatra përreth dhe ka pasur edhe goditje të fëmijëve nga veturat. Tjetër që dua të pyes ka të bëjë me instalimin e ngrohjes qendrore në shkollën e Volljakut. Mendoj që është një nevojë emergjente. Pastaj, kanalizimi i bllokuar në fshatin Sferkë. A parashihet një impiant i vogël që do ta evitonte përfshirjen e arave dhe fushave të fshatit Sferkë dhe Dush nga ujërat e zeza.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Ndërtimin e trotuarit në fshatin Volljak, do të ishte mirë që ta fusim në buxhetin e vitit 2020. E kemi dorëzuar një projekt buxhet për 2020 por mund të diskutohet edhe në shtator. Ngrohja qendrore në shkollë, kemi vendosë një fond rreth 100.000 euro për renovime në shkollë. Gjithashtu shkollë e Volljakut është edhe në projektin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, që është quajtur "Projekti për efikasitet", ku do të bëhet izolimi i shkollës me masat izoluese, ndërrimit të

dritareve etj. që do ti ndihmoj ruajtjes së energjisë. Për vitin e ardhshëm është një buxhet të cilin e kemi menduar ta orientojmë edhe në Volljak. Sa i përket impiantit të trajtimit të ujërave të zeza në Sferkë, nuk do të kisha mundur të them gjë pasi që janë shuma të mëdha mjetesh që kërkohen për ndërtimin e këtyre impianteve, dhe buxheti i Komunës është i limituar. Zgjidhja në këtë rast do të ishte me ndonjë kredi ose financim nga niveli qendror. Para llogaria për ndërtimin dhe funksionalizimin e një projekti për trajtimin e ujërave të zeza është rreth 10 milion euro. Nëse mund ta fillojmë në vitin 2021 këtë projekt do të ishte sukses.

z. Ramë Berisha: I nderuar kryetar. Rruga nga shkolla deri ne fshatin Dush do të ishte mirë të ndërtohet si dhe rruga deri tek varrezat e katër dëshmoreve të Dushit dhe dy të Sferkës.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Rruga që e lidhë shkollën me fshatin Dush, kujtoi që është e shtruar por problem është gjerësia e sajë. Ne po planifikojmë që në vitin e ardhshëm, me mbështetje financiare nga Ministria, të bëjmë renovimin e rrugëve që janë shtruar më herët. Të meremetohen rrugët me gropa dhe më pastaj të shtrohet një shtresë asfalt sipër. Për vitin 2021 edhe rrugën për të cilën folët do ta fusim në projekt.

z. Tunë Dedaj: Posa më shkruajti një qytetar, se në rrugën "Mirush Dakaj" që një javë është ndërprerë ndriçimi publik dhe askush nuk ka marr masa.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Faleminderit Ty Tunë dhe qytetarit. Ne do ta informojmë drejtorin e shërbimeve publike që të veproi.

Qytetar nga Stapanica(nuk prezantohet): Përshëndetje kryetar. Dëshiroi të pyes për rrugët e fshatit Stapanicë nuk janë shtruar të gjitha. A keni ndonjë projekt që të përfundon shtrimi i këtyre rrugëve të mbetura.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Në vitin 2020 e kemi një projekt për fshatrat Gllarevë, Rixhevë, Stapanicë. Tani për tani janë të planifikuara rreth 70.000 euro për këtë projekt por që do ti nënshtrohet aprovimit të Kuvendit. E di se ku kanë mbetur pa shtruar ato rrugica të vogla, besoi që vitin e ardhshëm do të shtrohen të gjitha.

z. Daut Gashi: Përshëndetje kryetar. Unë jam nga fshati Çabiq. Kam një pyetje për ujësjellësin i cili vije nga pusi i Jerinës deri në Ujmir, me të cilin janë rehabilituar fshatrat përreth. Edhe fshati Caravik ka bërë zgjidhje edhe pse nuk e di se a ka ujë të mjaftueshëm atje apo ska. Fshati i ynë ka mbetur në mes pa furnizim me ujë. A do të ketë ndonjë projekt për furnizim me ujë të pijes për fshatin Çabiq, nëse po, në cilin vit do të mund të llogarisim.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Projekti i ri, të cilin nuk e prezantova shumë, është projekt i shtrirjes së rrjetit të ujit të pijshëm për fshatrat, Perqevë, Rixhevë, Gllarevë, Stapanicë, Dobërdol, Zabërgjë, Çabiq, Caravik, një lagje e Gjurgjevikut të Madh. Është projekt i hartuar nga CDI, fond Zvicerran bashkë me Qeverinë e Kosovës, që kanë nda 900.000 euro për këtë vit dhe vitin e ardhshëm për implementim të tij. Ky projekt nuk ka filluar akoma, por mendohet që baseni kryesor të vendoset në Caravik dhe furnizimi të jetë më rënje të lirë. Para se të filloi ky projekt, ne duhet të japim argumente që do të ketë ujë të mjaftueshëm, në mënyrë që mos të investohet në shtrirjen e rrjetit dhe mos të ketë ujë për furnizim. Në të njëjtën kohë jemi duke bërë hulumtime gjeofizike për ujë të pijshëm në fshatin Përqevë, ku presim rezultate. Unë mendoi që projekti i furnizimit me ujë për të gjitha fshatrat e Komunës së Klinës mund të kompletohet në fund të vitit 2021.

z. Faruk Mulaj: I nderuar kryetar, e di se nuk keni shumë çasje rreth KEK, por ka disa investime në rrjet në fshatin Jashanicë. Sa jeni të informuar për këtë dhe a ka ndonjë marrëveshje të KEK me Komunën.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Me KEDS, investimet i koordinojmë bashkërisht. Ka filluar një projekt i ndërrimit të shtyllave tek lagja e "Hoti" në Jashanicë. Projekt që ka filluar vitin e kaluar dhe nuk po kompletohet. Jam shumë i pa kënaqur me investimet që ka bërë KEDS në Komunën e Klinës prandaj edhe i kam shprehë shqetësimet e mia. Kam marr premtime që do të investohet në ndërrimin e trafos tek shkolla e Sferkes, ajo trafo shërben edhe për furnizim të banorëve të fshatrave Dush, Qupevë dhe Volljak me ujë të pijes. Gjithashtu ka premtime në ndërrimin e trafos në fshatin Deiq dhe në dy projekte të reja. Përndryshe gjithçka shkon në koordinim me ne si Komunë por ata janë shumë pak të gatshëm që të bëjnë investime në rrjet, ndërkohë që kërkesat tona janë shumë të mëdha pasi që gjendja e rrjetit është shumë e rëndë në Komunën tona.

Kryetari i Komunës, z. Elezaj pasi që konstatoi se nuk dëshiron ta merr fjalën askush tjetër, ai duke i falënderuar të gjithë për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë në debat, e përfundoi takimin me fjalët: "Nuk është vetëm ky takim që e kemi obligim ligjor, vendtakim i yni. Dera e kryetarit të Komunës është gjithmonë e hapur për të gjithë. Jemi të gatshëm që të ju përgjigjem kërkesave dhe shqetësimeve të qytetarëve në çdo kohë".

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryetari i Komunës:

Prof. Dr. Zenun Elezaj